



**BASHKIA DIBËR**  
**KËSHILLI BASHKIAK DIBËR**

**VENDIM NR 90 Datë 30.06.2020**

**“Për Përdorimin e Fondit të Emergjencave Civile, nga Granti & Të Ardhurat”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, duke u mbështetur në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjit nr.88/2019 datë 18.02.2019 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, i miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër nr.140 datë 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me vendimin , nr.16/1 prot. datë 17.01.2020, ligji nr.45 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile” dhe VKM 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, kërkojmë që të përdoret fondi emergjencave civile për raste fatkeqësish dhe dëmtim shtëpie sipas projektit të dorëzuar nga Drejtoria e Planikimit Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave. Këshilli Bashkisë, në mbledhjen e tij, datë **30.06.2020 miratoi me 15 vota pro,5 vota kundër.**

**VENDOSI :**

- I.** Nga fondi i emergjencave civile, nga Granti & të Ardhurat, t’i jepet ndihmë për raste dëmtim shtëpie:
- 1- Lavdosh Arif Xhediku shuma prej 86,550 (tetëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë.
  - 2- Nexhmi Rifan Shini shuma prej 57,968 (pesëdhjetë e shtatëmijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.
  - 3- Zija Shukri Mehmeti shuma prej 80.162 (tetëdhjetëmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.
  - 4- Halil Fiqiri Dedja shuma prej 66,604 (gjashtëdhjetë e gjashtëmijë e gjashtëqind e katër lekë.
- II.** Pakësohet fondi emergjencave civile **1810** në vlerën **291,284** (dyqind e nëntëdhjetë e njëmijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë dhe shtohet struktura **1110** llogaria **604** në vlerën **291,284** (dyqind e nëntëdhjetë e njëmijë e dyqind e tetëdhjetë e katër) lekë.

Adresa: Bulevardi “ELEZ ISUFI”, Peshkopi, [email:bashkiadiber@gmail.com](mailto:bashkiadiber@gmail.com) nr.tel:0035521822935

- III. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e PPECK dhe Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.

---

Sekretare Këshilli

Inva TRUPJA



Kryetar Këshilli

Sokol SAVA

